



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUŠTRRN	
DI Nr. / Br.	230/22
Nr. i fq. / Br. si	- 9 -
Data: / Datum:	29.09.2022
VUŠTRRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS
SËVUSHTRRISË, MBAJTUR MË 6 SHTATOR 2022**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Spasoje Stefanoviq, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Gentiana Rama dhe Nurie Halili.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – Kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës - z. Ferit Idrizi, nënkyetari i komunës - z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - pasi përrshëndeti të pranishmit, arsyetoj thirrjen e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme, me qëllim të diskutimit të buxhetit të komunës për vitin 2023, dhe po ashtu edhe procedimi i statutit të komunës i cili nuk u aprovua në mbledhjen e kaluar. Ai njoftoi se procedimi i draft-buxheti në këtë mbledhje për shqyrtim është bërë me qëllim të rritjes së transparencës dhe përmarrje së shumës së parashtruar të gjitha kërkuesat. Pastaj apeloi tek anëtarët e kuvendit që si përfaqësues të qytetarëve ti prezantojnë me shkrim kërkuesat e tyre me qëllim që ato të futen në buxhet, dhe që bashkërisht të aprovojmë buxhetin dhe që ai të jetë gjithëpërfshirës dhe me shtrirje në të gjitha lokalitetet. Ajo që është identifikuar si nevojë dhe kërkuesë është që të kemi më shumë mijte tek ujësjellësi dhe kanalizimi me që qëllim që të kompletohet infrastruktura. Në fund propozoi që të futet në rend të ditës një propozim-vendim për ridestnimin

e mjeteve financiare për mbulimin e mjeteve shtesë për projektin “Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc” me kod 52188.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se propozimi i kryetarit të komunës lidhur me ridestinimin e mjeteve financiare të komunën për mbulimin e mjeteve shtesë për projektin “Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc” me kod 52188, është i natyrës urgjente, andaj bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kërkoi që kjo pikë të futet në rend të ditë për shqyrtim dhe aprovim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se le të shikohet ana ligjore lidhur me propozimin e kryetarit të komunës, dhe ata si subjekt politike nuk janë që ti bllokojnë proceset, pasi që dihet që jemi në kohen e një krize të madhe financiare dhe kësisoj ekziston rreziku që shumë mjetë të shkojnë në suficit e kjo do të ishte tepër e dëmshme për komunën dhe qytetaret e komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se grupi kuvendar i LVV-së e përkrah propozimin e kryetarit të komunës për financimin e projektit “Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc” me kod 52188.

Pas shqyrtimit , kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Draft-buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2023-2025;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Statutit të Komunës së Vushtrrisë;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Përparimi” në Vushtrri.
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare të komunës së Vushtrrisë.

1. Shqyrtimi i Draft-buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitet 2023-2025;

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se në buxhetit të komunës në vlerë prej 23,373,910 € ia heqim shifrën prej 10, 796, 373 € mjetë këto që janë të dedikuar për mbulimin e shpenzimeve të pagave atëherë komunës i mbesin mjetë financiare në vlerë prej 12,577, 537 € për planifikim. Duke parë materialin e buxhetit vërehet se janë bërë punë të mira dhe planifikim adekuat dhe akomodim të kërkeseve e nevojave në buxheti sidomos në arsim, ku është planifikuar që në lagjen “Caka” ku paraqitet kostoja e meremetimit të projektit. Mandej parashtroj edhe dy kërkesa për inkorporim në buxhetin e komunës: në të gjitha shkollat të nderohen tabelat ku shkruhet me shkumës, të gjitha shkollat të pajisen me nga një fotokopje. Mandej për vitin 2023 nuk është paraparë ndërtimi iasnje shkolle. Në disa linja buxheti ka paqartësi gjëra të përgjithësuar dhe jo të shkoqitura mirë, konkretisht tek pika 11 planifikim në Drejtorenë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ku vetëm tregohet komulativi i mjeteve në vlerë prej 1,200,000 €, dhe nuk tregohet në cilin fshat dhe në cilën rrugë ku do të kemi asfalttime të reja etj. Pastaj pyeti se përsë nuk janë asfaltuar rrugët që janë planifikuar vitin e kaluar konkretisht rr.”Sadik Mala” vazhdimi deri tek varrezat ku ka zëra se kjo rrugë është hequr fare, nëse po kush e hiqi nga planifikimi, ka shkuat ato mjetë nëse është përgjysmuar në dy vite pse ka ndodhur një gjë e tillë nëse hyn në planifikim për këtë vit atëherë kur do të kryhet. Në fund tha se sot po vendoset për dokumentin ma të rëndësishëm të komunës siç është buxheti, por anëtarët e kuvendit kanë dilema në votimin e këtij buxheti pasi që projektet nuk janë të emërtuara por vetëm jepen në shifra të përgjithshme.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës –sqaroi se tani buxheti i komunës ka ardhur vetëm për shqyrtim, derisa kërkoj nga grupet kuvendar që ti parashtrojnë kërkesat e tyre, që të inkorporohen në buxheti dhe se deri në seancën e radhës buxheti do të vjen në kuvend me projekte të specifikuara. Tani ndodhemi në fazën e nënshkrimit të disa kontratave me buxhetin e vitit 2021, ndërsa ndërtimi i disa rrugëve me asfalt ka vazhduar nga kontratat për projektet dy vjeçare. Buxheti për vitin 2023 është më i madh për më tepër se 1 milion euro sa i përket investimeve kapitale.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti të pranishmit, bëri apel tek institucionet lokale e veçanërisht tek koleget e tij mësimdhënës që sa më parë ta fillojnë procesin mësimor ashtu që mos të pësojnë nxënësit. Tutje shtoj dhe kërkoj që procesverbalia nga dëgjimi publik në fshatin Stanoc të jetë pjesë e materialit për buxhet në mbledhjen e radhës të kuvendit, dhe kërkesat e evidentuara nga ai dëgjim publik të inkorporohen në buxhetin e komunës për vitin 2023. Në vazhdim ai prezantoj kërkesat e dëgjimit publik si në vijim: rregullimi i furnizimit me ujë të pijes në fshatin Stanoc i Epërm atu ku kemi problem por edhe në fshatin Gracë sepse edhe atij ka disa familje që kanë problem serioze me furnizim me ujë, investimi në rregullimin e tri prrockave për ti shmangur vërvshimet në fshatin Stanoc i Epërm, rregullimi i dy parqeve rekrative apo fushave sportive në Stanoc të Epërm njëra prej tyre në lagjen Shala, Bregaj, Hasani, Maloku dhe tjetra për lagjet: Haradinaj, Haxhaj Kosumi, asfaltimi i rrugëve me prioritet dhe që kanë frekuentim të më të madh siç janë: rr. "Vjena", rr. "Kadri Haradinaj", rr. "Bajram/Selim Cakaj" rr. "Faik Pronaj", rr. "Bislim Pronaj", rr. "Murat Sopjani", rr. Shefqet Hardinaj" rr. "Naser Haradinaj", rr. "Naim Haradinaj", rr. "Sahit Kosumi", "Aziz Maloku", rr. "Besim e Arsim Maloku", rr."Lavdim Haradinaj". Pastaj rregullimi i trotuareve në rr. "Dalip Maloku" që ka mbetur në gjysmë, mandej trotuar në rr. "Bahri Cakaj" në afërsi të shkollës, në rrugën "Skender Vllaca" rr. "Amerika", rr."Sadik Malaj". Rregullimi i kanalizimeve dy kanalizime në lagjen Haradinaj dhe dy tjera në lagjen Pronaj. Rregullimi i ndriçimit publik aty ku janë vendosur shtyllat elektrike në rr. "Amerika" rr. "Qerim Shala" rr. "Beqir Caka" rr."Ylber Haradinaj" rr. "Arbenita Tarakaj", rr."Myrvete Haradinaj". Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave, rregullimi i urës në lagjen "Cakaj" në afërsi të rr."Myrvete Haradinaj". Po ashtu nga fshati Gracë kemi kërkesa për rregullimin e ujësjellësit dhe asfaltimin e rrugëve në këtë fshatë. Fshati Lumadh ka kërkesë të rregullohet ura në afërsi të lagjes "Gashi", po ashtu ndërtimi i një ure në bashkëpunim me ministritë kompetente mbi lumin "Silnica" për të mundësuar punimin e ngastrave kadastrale, e po ashtu ka kërkesë për investime në stadiumin e fshatit. Nga fshati Mihaliq kemi kërkesë që të bëhet asfaltimi i rr. "Bashkim Kombëtar", në gjatësi 500 metra, dhe aneksi i rrugës "Adriatiku" me gjatësi 700 metra. Fshati Maxhunaj ka kërkesë për asfaltimin e rr. "Drita", asfaltimi i rr. "Tefik Krasniqi", në gjatësi 300 metra. Në fshatin Novolan asfaltimi i rr. "Bislim Vatovci" me gjatësi rrëth 300 metra. Në fshatin Druar meremetimi i kroit të fshatit. Mandej tek investimet në bujqësi kemi parë qe ka një zvogëlim të investimeve kërkojmë që këto investime të rriten. Për drejtoreshën e Arsimit bëri pyetje si është gjendja me furnizim me ujë në shkollat e Komunës së Vushtrrisë, dhe nëse ndonjë shkollë nuk është e kyçur në ujësjellës kjo të bëhet me qëllim të furnizimit me ujë të pijes për nxënësit dhe mësimdhënësit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- të nderuar qytetar të Komunës së Vushtrris ju deputet dhe ju të pranishëm kryetari i komunës z.Ferit Idrizi për vitin 2023 ka shpallur top prioritet apo priorititin nr. 1 realizimin e projektit investivë me moton kyqjen në ujë të pijshëm dhe kyqjen në kanalizim për çdo shtëpi në tërë territorin e Komunës së Vushtrris në të gjitha lagjet urbane dhe fshatrat pa pasur nevojë për participim nga asnjë qytetar ky prioritet njëzëri është përkrahur edhe në KPF dhe

KPF ka propozuar dhe votuar për thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme me qëllimin që të gjithë subjektet e përfaqësuara në kuvend dhe jo vetëm të kenë mundësi të analizojnë edhe njëherë buxhetin për vitin 2023 të debatojmë nëse ka propozime konkrete dhe që ofrojnë shërbime më të mira për qytetaret sigurisht do të jemi transparent gjithsecili propozim do merr epilogun meritor, andaj ju ftoj që të gjithë të bashkohemi në këtë rrugëtim të përbashkët pozitë dhe opozitë. Për përfundimin me sukses të këtij projekti që do të ndërroj jetën e shumë qytetarëve nëpër fshatra e qytet e sidomos fshatrave tona kryetari tani veç ka planin dhe strategjinë e realizimit por në këtë projekt kërkohet përkrahja e të gjithë akterve dhe unë bëjë ftes te të gjithë ju që këtë draft buxhet 2023 e që është akti më i rëndësishëm komunal që shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme ta votojmë unanimisht dhe të kemi hisen e barabartë në përgjegjësitet që kemi karshi qytetarit po edhe më së largu në dhjetor të 2023 kur do të shpalosmi rezultatet dhe realizimin e këtij projekti jetik e me të cilin do të krenohemi të gjithë dhe do të festojmë bashkërisht si e arritur e të gjithë neve por edhe sigurisht do jemi qyteti apo komuna e parë në Republikën e Kosovës po edhe në rajon që kemi përfunduar furnizimin me uje dhe kyqjen në kanalizim në tërë territorin e komunës. Institucionet komunale e sidomos kuvendi i komunës kanë kompetencia që të ndikojnë drejtpërsëdrejti në kualitetin e jetës së qytetarëve duke filluar nga sigurimi i ujit të pijshëm, kanalizimi, ndërtimi i rrugëve, trotuarëve, shkollave dhe qendrave të mjekësisë familjare e deri tek subvencionimi i veprimitarive ekonomike, mikrobizneseve, fermerë etj. Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët dhe palët e interesit. Komuna jonë i ka dhanë rëndësinë e merituar konsultimit publik për këtë proces të rëndësishëm, madje konstatim i përgjithshëm është se ka pasur edhe përmirësim nga vitet e kaluara. Të nderuar qytetar dhe ju koleg deputet Buxheti i komunës i ka pesë kategori: 1.Paga dhe mëditje, 2.mallëra dhe shërbime, 3.shpenzime komunale, 4.subvencione dhe 5.investime kapitale. Shuma totale e buxhetit dhe ndarja e tij në pesë kategoritë bëhet nga Ministria e Financave për shkak të rëndësisë së grantit qeveritar që ka në financimin e qeverisjes lokale andaj Buxheti i komunës kalon në katër fazë që janë: 1.hartimi, 2.miratimi, 3.zbatimi dhe 4.rishikimi. Qytetarët mund të jepin kontributin e tyre në fazën e parë të bërjes së buxhetit – hartimin, në dy kategoritë e fundit të buxhetit – subvencione dhe investime kapitale, konkretisht në shpërndarjen e shumave të paracaktuara brenda këtyre dy vijave buxhetore. Kontributi i qytetarëve është i limituar pra në vetëm dy kategori dhe në formë të propozimit për shtim apo heqje të një projekti apo uljes/ ngritjes së një shume të dedikuar për një projekt apo subvencion, në një listë tashmë të draftuar nga komuna.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit- i nderuar kryetar i nderuar nënkyetar kolege asamblist dhe ju të dashur qytetar unë për buxhetin e vitit 2023 kam listuar disa kërkesa që kanë ardhur si rezultat i mbajtjes se takimit me qytetare në dëgjimet buxhetore që janë mbajtur në shkollën e fshatit Strofc, te cilat kërkesa do i paraqes edhe këtu Në fshatin Strofc te bëhet Renovimi i kulmit të Shkollës "Liria" Stroc, kulmi gjatë reshjeve dhe gjatë stinës së dimrit pikon. Trotuari për nxënës nga shkolla në gjatësi prej 1 km, Asfaltimi i rrugës Ahmet Ademi në gjatësi prej 150 metra. Rruga lidh fshatin komplekt e cila paraqet probleme për gjithë fshatin për shkak të terrenit të vështirë. Asfaltimi i rrugës Maliq Hasani në gjatësi prej 150 lagjja Hasani Strofc. Ndërtimi i kanalizimit në rrugën 7 Dëshmorët lagja Tahiri ku përfshihen 10 shtëpi. Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Shabani Strofc gjatësi 400 metra. Zhilivodë: Asfaltimi i segmenti të rrugës "Ahmet Krasniqi" në gjatësi 150 metra rruga Fahri Krasniqi. Në fshatin Bivolak rruga Berishaj 150 Metra Fshati Beçuk 1. Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Beçuk Rr."Tafil Murati " në gjatësi prej 500 metra, e cila i përfshinë 8 shtëpi. Fshati Gllavatin: 1. Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Gllavatin në gjatësi 500 metra në

rrugën “Driton Islam Hasani” ku përfshihen 10 shtëpi pra këto janë kërkesa për 5 fshatrat nga të cilat kërkoj nga ju i nderuar kryetar të merren parasysh dhe te futen ne linja buxhetore për vitin 2023. Ju faleminderit!

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-kërkoj që një shtëpi në lagjen Bregaj në Stanoc të Epërm të kyjet në rrjetin e kanalizimit. Po ashtu të bëhet kyqja në kanalizim në lagjen Bregaj afër zonës ekonomike në fshatin Stanoc i Epëm.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-ri-përsërit kërkesën e tij për rregullimin duke e futur në buxhet rrugën që fillon nga Podrança në drejtim të fshatit Sumë, për faktin se ajo rrugë është aq e dëmtuar sa që gati është e bërë e pakalueshme. Mandej në fshatin Torllobuq është duke u eksplatuar një shkëmb guror dhe për pos që janë shkatërruar rrugët, është dëmtuar tej mase edhe fshati nga eksplodimet për shfrytëzimin e shkëmbit për materiale gurore. Andaj kërkoj që rruga të futet në projekt-buxhet për riparimin e saj. Më tej shtoj dhe vlerësoi se fshatrat që shtrihen në veri të qytetit sikur janë lënë anash andaj kërkoj nga komuna që ketë fokus edhe në këto lokalitete me investime në infrastrukturë.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se transporti publik ka problem të mëdha, dhe kërkoj nga komuna që të intervenohet me hartimin e një plani operativ ku do të bëhej e mundur rregullimi i tij. Komuna duhet të ketë parasysh sidomos në mbulimin e shpenzimeve me participim prej 50% të shpenzimeve të transportit për nxënësit tanë, kjo është shumë e nevojshme për shkak të krizës së madhe që po mbretëron kohëve të fundit.

Alban Bajrami, anëtar i kuvendit-parashtroj temën për renovimin e çerdhes së qytetit, të cilën e kishte propozuar si projekt në rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2021 por që tani nuk e sheh që është i inkorporuar, dhe nëse kjo është kështu atëherë pse ka ndodhur një gjë e tillë. Përkrahja e tij për buxhetin muaj më parë ishte në mirëbesim për aprovimin e propozim-kërkesave që i kishte parashtrua atë kohë. Në këtë kontekst kërkoj sqarim lidhur me statusin e propozimit të tij për renovimin e çerdhes publike.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-statutit të Komunës së Vushtrrisë;

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - pasi përshëndeti të pranishmit tha se është nevojë e kohës që të bëhet përshtatja e statutit të komunës me zhvillimet aktuale dhe harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi. Tek neni 53 propozoj që në qoftë se një zyrë ka detyra të përafërtë me një departament atëherë të lihet mundësia që ajo zyrë të integrohet në kuadër të departamenti me qëllim të shmangies së duplikimit të funksioneve.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se në mbledhjen e kaluar, kur draft-statuti dështoi që ta aprovohet kryetari kishte premtuar se do të organizonte një tryezë të rrumbullakët mes grupeve kuvendar dhe asamblesë komunale, që të diskutohet lidhur me statutin e komunës por kjo nuk ndodhi, nuk jemi ftuar dhe s’ka pasur asnjë lloj diskutimi për këtë temë. Si grup kuvendar i LDK-së janë pro harmonizimit të statutit të komunës me ligjet në fuqi, sepse ka një kohë të gjatë që statuti aktual i komunës nuk është rifreskuar, dhe për këtë mbesin prapa qëndrimi që ka dhënë anëtarë i komisionit statutar nga LDK-ja, që numri i drejtive të mbetet i pandryshuar në 12 drejtori ashtu siç është aktualisht dhe kompetencat e drejtive të mbesin të njëjtë, në këtë formë ata e përkrahin statutin dhe mbesin prapa qëndrimeve të subjektit të tyre politik, dhe po ashtu kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që vota të numërohen saktë sepse në mbledhjen e kaluar votat nuk janë numëruar saktë dhe për këtë kërkoj që rishikohen incizimet e mbledhjeve të kuvendit dhe për këtë të ofrohet një raport.

Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit, në adresimin e tij vlerësoi se jemi duke diskutuar një pikë të rendit të ditës e cila në mbledhjen e kaluar të kuvendit është rrëzuar nga shumica e votave të anëtarëve të kuvendit, dhe kjo nuk është çfarëdo pike, por po flasim për statutin e komunës që është akti më i lart juridik i komunës që rregullon strukturën dhe organizmin e brendshëm të komunës, realisht është kushtetuta e një komune. Pas situatës që ishte në mbledhjen e kaluar kishte zotim nga kryetari i komunës dhe subjekti i tij politik që për këtë çështje do të organizohet një tryezë e rrumbullakë do të zhvillohej një debat pak më i gjërë, ku secili asamblist dhe pse jo qytetar do të jepte kontributin e tij, për një statut moritor çfarë realisht ka nevojë Komuna e Vushtrrisë, por në të vërtet thuaj se asgjë nuk ka ndryshuar nga statuti aktual i komunës. Kësisoj tendencia që të sillet në kuvend statuti i rrëzuar tashëm nga kuvend, që me metoda të ndryshme të kalohet duke shmangur transparencë publike dhe diskutimin për statutin nuk mendon se është e mirë. Në nivel qëndro ka ekzistuar një qeverisje famëkeqe e quajtur PAN, e cila është konsideruar nga raportet e progresit se ka pasur nivel pandemik të korruptionit dhe ajo qeverisje ka krijuar aq shumë ministri dhe ka emëruar zëvendësministra sa që as kryeministri nuk i ka ditur emrat e zëvendësministrave. E njëta qeverisje PAN ka zbritur në nivel lokal e që fatkeqësish me logjiken e njëjtë po tenton të rrit numrin e drejtorive komunale, vetëm e vetëm për akomodimin e disa individëve e që fare nuk e ka për bazë interesit qytetar. Si grup i LVV-së kanë qëndrimin e tyre se me qenë se nuk janë ftuar për ta jap kontributin e tyre dhe më që ka munguar transparenca, dhe se nuk pajtohen me rritjen e numrit të drejtorive komunale nuk do ta votojë se të këtillë këtë statut, për ndryshe nëse krijohen kushtet e dialogimit, bashkëpunimit, transparencës përkrahin pjesën tjetër të statutit, por me që një gjë e tillë nuk është arritur ata do ta kundërshtojnë me votë statutin e komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimit të parafolësit të tij vlerësoi se diskutimit i tij është i pa vërtet dhe tendencioz dhe e lut atë që mos të bie në kësi lloj niveli të debatit sepse edhe ai vet e di që gjërat që i tha nuk janë të vërteta. Përtej kësaj vlerësoi se nuk duhet të zurret në kuvendi e komunës debati me ngjyrime politike dhe tendencia me komprometua njerëz veç pse jemi në parti të ndryshme. U tha se ka munguar transparenca publike sikur në qeverisjen famëkeqe të quajtur PAN, nuk dëshiron të lëshohet në këtë debat, por e lutë parafolësin që jap kontributin në nivelin komunal dhe për statutin e komunës që është në shqyrtim. Sa i përket transparencës për statutin e komunës ceku se ajo ka qenë e plotë, ndërsa subjektet politike LVV dhe LDK, kanë pasur vërejtje sa i përket numrit të drejtorive, ku njëra ka kërkua që të jenë 15 drejtori ndërsa tjetra 12 e si konsensus PDK ka arritur ujdi në 14 drejtori. Mandej kërkoi që statutit të aprovohet me propozimet nga seanca e kaluar, ndërsa pjesë të statutit duhet të jenë edhe propozimet e z.Haki Maloku të cilat do ti procedohen kryesuese së kuvendit. Në vazhdim shtoi se ky statut nuk po bëhet vetëm për një subjekt politik, por për organizimin e komunës sepse ka nevojë të bëhet ndryshimi i strukturës organizative të komunës dhe të bëhet harmonizimi i statutit me ligjet aktuale me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët. Në fund tha se duhet të tejkalojen praktikat jo të mira dhe inatet politike dhe statutit të aprovohet me vota unanime pasi që është në interes të përgjithshëm.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-vlerësoi se edhe në të kaluarën por edhe tani gjithherë ka bërë përpjekje që ta ketë një rol të unititetit, dhe shtoi se ajo çka është në interes të përgjithshëm qytetar duhet të mbështet nga të gjithë pavarësisht se cila parti politike propozon. Pastaj shtoi se nëse diçka bie në kundërshtim me interesin qytetar ai personalisht kurrë nuk do ta përkrahte. Ai apeloi për transparencë publike dhe për kulturë të dialogut dhe kulturë politike duke i marr për bazë ankesat e parive opozitare. Në fund kërkoi nga të gjithë që të jemi unik dhe kompakt që të veprojmë me arsy e me ndërgjegje në interesin e përgjithshëm dhe ri-potencoi se çështjen e statutit nuk është

se e njehë në hollësi po një gjë e di se ky statut është për komunën e jo për partitë politike.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se grupi kuvendar i LDK-së asnjëherë nuk ka dal kundër interesit të përgjithshëm qytetar dhe ka votuar pro për vendimet e tilla duke i ndihmuar pushtetit aktual me vota në kuvend, në rastin konkret propozimi i tyre është që statutit të harmonizohet me ligjet aktuale, numri i drejtoreve komunale të jetë 12 drejtori dhe kompetencat e drejtoreve të jenë të përshkruara në statut.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës –sqaroi se të thuash se nuk ka pasur transparencë në hartimin e statutit kjo nuk është e qëndrueshme, sepse komisionet për hartimin e akteve komunale i harton ekzekutivi komunal, në rastin konkret me qëllim të rritjes së transparencës komisionin e ka themeluar kuvendi ku janë përfshirë të gjitha partitë politike. Pastaj shtoi se ky dokument i ka kaluar të gjithë filtrat dhe procedurat ligjore duke shpallur diskutimin publik dhe duke marr edhe opinion e akterve që janë relevant në këtë proces. Sa i përket numrit të drejtoreve me statut krijuhet një fleksibilitet në organizimin e punëve të drejtoreve komunale, sepse është fakt se me votën tonë po bëjmë rregullore të cilat po i bllokojnë proceset komunale. Për këtë përsëriti rastin e rregullores për bursat e cila ka shkaktuar bllokada sa i përket ndarjes së bursave për shkak të kritereve rigjide që i ka përcaktuar. Andaj fleksibiliteti i organizimit komunal deri në 14 drejtori, krijon një koncept të mirë përfunksionim më të mirë dhe hapë rrugë për adresimin më të mirë të kërkesave dhe përofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Tute shtoi se ndryshimi i statutit është nevojë e kohës, sepse duhet të kemi në konsideratë nevojën dhe specifikat e zhvillimit të komunës sonë dhe për këtë mori shembull Komuna e Vushtrrisë së komunë me relief bujqësor nuk e ka Drejtorinë e Bujqësisë sepse për ndryshimin e emrit të drejtorisë nevojiten 2/3 e kuvendi dhe kjo është pengës për zhvillim. Sa i përket mendimit se statuti është rrëzuar në seancë e kaluar vlerësoi se kjo është e paqëndrueshme sepse shumicën e vota i ka pasur, por që për aprovimin e tij nevojiten 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit. Në fund kërkoj nga të gjitha subjektet politike që me vota unanime ta aprovojnë statutin e komunës, por veçanërisht kërkoj nga anëtarët e kuvendit që kanë qenë pjesë e komisionit që mos ta hedhin poshtë punën e tyre dhe ta votojnë këtë statut sepse ata kanë qenë në cilës të eksperte kur e kanë hartuar këtë statut.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-tha se personalisht si shef i grupit dhe si koordinator i LVV-së në Vushtrri, nuk është ftuar, nuk ka pasur takim dhe as që është marr mendimi i tij sa i përket statutit dhe aprovimit të tij. Pastaj njoftoi se ka informata se individualisht kryetari i komunës ka takuar asamblistë të ndryshëm edhe nga subjekti i tij politik, por edhe nga subjektet tjera politike. Kjo çështje është në dorën e kuvendarëve, dhe ata vetë le ta vlerësojnë nëse kanë vullnet për ta votuar ose jo këtë statut. Mirëpo koha do të kaloj dhe do të vijmë tek situata e ballafaqimit në media dhe në emisione publike, kur nuk do të mundeni lehtë të ikni nga pyetjet, nga përgjigjet dhe nga e vërteta, do të vjen koha kur do të dalin në dritë edhe pazaret politike individuale të secilit me juve ose të juajat me secilin individ-anëtarë të kuvendit për të kaluar gjëra të tilla, e që si rrugë politike për gjetjen e mekanizmave për të kaluar vendimet e tilla nuk është e lavdërueshme, këtë dhe kështu mendojnë edhe shumë asamblistë dhe përkrahës të kryetarit të komunës që atij ia kanë thënë në kushte private dhe takime private. Për interes të përgjithshëm gjithherë janë të gatshëm të ulën dhe të dialogojnë si grup kuvendar i LVV-së, por si grup kuvendar nuk janë kontaktuar dhe ftuar andaj le të mbetet në vullnetin e secilit anëtar për ta votuar ose jo këtë statut.

Melihate Basholli-Latififi, Kryesuese e kuvendit-në rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, konstatoj se prezent në sallë janë 33 anëtar të kuvendit, ndërsa e qetë në votim Statutin e Komunës së Vushtrrisë me vërejtjet dhe propozimet nga mbledhja e kuvendit e datës 28.07.2022.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” 9 vota “kundër” aprovoi Statutin e Komunës së Vushtrrisë.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Përparimi” në Vushtrri;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që mos të procedoj në kuvend materiale të cilat nuk kanë kaluar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, sepse shumë, vendime po kthehen si të kundërligjshme nga MAPL-ja. Në këtë kohë krize duhet të mbështet ndërmarrja në fjalë, dhe grupi i tij kuvendar do ta mbështes këtë pikë të rendit të ditës, por fillimisht duhet marr mendimi i ekspertëve të financave se subvencionimi në këtë formë i kësaj ndërmarrje a paraqet ndonjë shkelje ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se subvencionimi i kësaj ndërmarrje është i natyrës urgjente për shkak të krizës së madhe, dhe për këtë kjo pikë është proceduar në mbledhje të jashtëzakonshme, procedimi është konform ligji sepse për çështje urgjentet pikat e rendit të ditës mund të procedohen në kuvend pa kaluar në mbledhjen e KPF-së. Ai mbështet përpjekjet përfunksionalizimin e plotë të N.P.L. “Përparimi” dhe ceku se duhet të ketë konsideratë se pagat në këtë ndërmarrje janë shumë të ulëta, andaj propozoi që të caktohet tavani i pagës minimale në këtë ndërmarrje në 400 €

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Përparimi” në Vushtrri në vlerë financiare prej 90,000.00 €.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të merren nga kategoria subvencione dhe transfere, programi Infrastrukturë Publike (18184), nga të hyrat e bartura (fondi 22).
3. Qëllimi i subvencionimit të N.P.L. “Përparimi” është përkrahja financiare, për ngritjen e qëndrueshmërisë të kësaj ndërmarrjeje, si rezultat i krizës së madhe ekonomike dhe shkallës së lartë të inflacionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare të komunës së Vushtrrisë;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve financiare në vlerë 10,003.00€, të cilat transferohen nga programi Arsimi (93690), Projekti “Ndërtimi i shkollës në Gllavatin” me Kod 52191, në

programin Planifikimi urban (66425) në projektin “Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc” me Kod 52188.

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi mbeten në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale dhe në kuadër të fondit të njëjtë, Fondi 22.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Formulari i Thesarit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:35.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit